



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

NJOFTIM

Në zbatim të nenit 26, pika 9, të Rregullores së Maturës Shtetërore 2019, të gjithë maurantët/kandidatët që do të japin provimet e MSH 2019, kanë të drejtë të kërkojnë fotokopjen e testit dhe të fletëpërgjigjes, pas përfundimit të të gjitha provimeve.

Çdo maurant/kandidat që kërkon fotokopjen e testeve të Maturës dhe të fletëpërgjigjeve përkatëse, duhet të paraqesë kërkesën në shkollë **brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultateve të secilit provim.**

ZVAP mbledhin kërkesat për fotokopje nga çdo shkollë dhe i dorëzojnë ato në QSHA **brenda 4 ditëve nga shpallja e rezultateve të secilit provim.**

Gjithashtu, informohen të gjithë maurantët/kandidatët se kërkesat për fotokopje të testit dhe të fletëpërgjigjes mund të kryhen online në portalin e-albania, duke përdorur shërbimin “**Kërkesë për kopje të testit të Maturës**”, **brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultateve të secilit provim.**

Pas trajtimit të kërkesës, QSHA do të nisë kopjen e testit për secilin maurant/kandidat që e ka kërkuar atë, në “Hapësira ime”, seksioni “Dokumentet e mia”, në llogarinë përkatëse të çdo maturanti/kandidati, në e-albania. Maurantët/kandidatët do të njoftohen edhe me e-mail, në kohën që shërbimi do t’u kthejë përgjigje.

Ky shërbim ofrohet nga QSHA pa pagesë.

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Rezana VRAPI